

MAXIMILIAN LAMBERTZ (1882-1963)

Më 26 gusht 1963, pak pasi kish mbushur tetëdhjetenjë vjet të jetës së tij, vdiq në Leipzig Maximilian Lambertzi.

Lambertzi pat lindur më 27 korrik 1882 në Vjenë, ku edhe kreu studimet e mesme e të lartat, duke u specializuar në gjuhësinë e krahasuar indoeuropiane të Paul Kretschmeri e në filologji klasike (të E. Hauleri e L. von Schroederi) drejtim studimesh që depërton gjithë punimet e tij. Në fillim të karrierës së tij shkencore u muar me gjuhësinë greke; më 1907 botoi «Emrat e skllëvërve grekë», dhe një varg artikujsh sidomos të revista «Glotta», gjatë së dytës luftë botërore ai bashkëpunoi në München në hartimin e «Thesaurus linguae latinae». që në të ri nisi e iu kushtua studimeve shqiptare, dhe kësaj lëme kërkimesh i mbeti besnik gjër në fund të jetës së tij.

Maximilian Lambertzi nuk është një nga ata dijetarë që janë të specializuar vetëm në një degë të caktuar. Në studimet e tij ai me një shumësi tematike të rrallë rrok, mund të themi, kompleksin e studimeve shqiptare në tërësinë e tij. Sidomos i ka kushtuar një vëmendje të veçantë e të pandërprerë literaturës popullore e artistike, gjuhësisë dhe etnografisë e të folklorit në kuptimin më të gjërë të kësaj fjale.

Zhvillimin e literaturës shqiptare ai që më 1922 (në mbledhjen e botimit gjermanisht të përrallave shqiptare, me titullin «Midis Drinit e Vjosës, f. 6 v.) me një mënyrë origjinale e pa se ka nisur e u krye në disa qarqe krahinore-konfesionale, si ai i Shkodrës në Veri, i Shqipërisë së mesme, i Jugut, i kolonivet etj., gjersa në shekullin e kaluar u derdh në rrjedhën e përbashkët të literaturës nacionale. Te

historia e te karakteri i përgjithshëm i literaturës shqiptare ky dijetar është kthyer disa herë, sidomos në studimin «Gjeneza e zhvillimi i literaturës shqiptare» që u botua më 1948. Ky ravizim në kontura të përgjithshme zgjerohet e thellohet pastaj nëpër disa studime të veçanta. Nga këto do përmendur sidomos monografia e vitit 1949 «Gjergj Fishta dhe epi heroik shqiptar Lahuta e Malcis. Një hyrje në botën e legjendave shqiptare», ku jepet përmbajtja e këtij epi këngë më këngë, bashkë me një karakteristikë të poetit dhe të veprës së tij. Disa vjet më vonë (1958) ai na fali përkthimin gjermanisht, artistikisht të përkthyer, të këtij eposi («Die Laute des Berglandes»), të pajisur me një hyrje e me shënime të vlefshme. Ky përkthim është i vetmi i plotë gjër më sot dhe është më i miri nga përkthimet e këtij epi. Te kjo temë që e ka pasur për zemër, dijetari ynë është kthyer shpeshherë në veprat e tij, më në fund në artikullin «Çështja homerike dhe epi i madh shqiptar». Aty shtjellohet në një dritë të re çështja e gjenezës së epi artistik prej këngësh popullore, çështja e rrahur kaq shumë që prej Friedrich August Wolfit (1795) e këtej. Nga literatura e elementit arbëresh të Kalabrisë është për të përmendur këtu studimi i vitit 1956 mbi Jul Varibobën dhe «Gjellën e Shën Mërisë Virgjërë 1) të vitit 1762. Këto punime janë fryti i një thellimi disa dhjetëvjetësh e të frymëzuar në këto dy personalitete poetësh dhe një dëshmi e zotërimit të plotë të lëndës nga ana e autorit. Ky ndërkaq ka ndjekur vazhdimisht edhe zhvillimin më të ri të literaturës shqiptare. Për këtë përveç essayve të ndryshme dëshmojnë

1) Kuhns Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung 74, f. 45-122, 185-224.

edhe përkthimet e shumta që ka bërë, ndër të tjera sidomos ajo e dramës «Toka jonë» të Kolë Jakovës. Ai ka lënë në dorëshkrim dhe një punim të gjatë me titullin «Drama në teatrin shqiptar të sotmën».

Në fushën e gjuhësisë dialektologjia, sintaksa e onomastika te ky dijetar zënë një vend më të rëndësishëm sesa etimologjia e gramatika historike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, me gjithë se atij edhe në këto fusha i detyrohen disa konstatime të rëndësishme.

Studimet dialektologjike të tiat mbështeten në kërkime të thelluara në terren. Ai e nisi punën (në vjetet 1913 e 1914) me të folët e kolonivet arbëreshe t'Italisë, e pikërisht të pjesës më veriore (Abrucet, Molize, Kaptanata), të cilat dihehin më pak se ato të Bazilikatës, Apulisë, Kalabrisë e Siqelisë që gjinden më në jugë. Rëndësia e këtyre ligjërimeve, të cilat, të shkëputura prej shekujsh nga trugu i dheut mëmë, paraqesin mbeturinën e fundit të shqipes mesjetare, dihet mirëfillit prej gjithë atyre që gjurmojnë zhvillimin historik të shqipes e të sistemit të saj fonetik, gramatikor e leksikal. Lambertzi pikësepari (në Indogermanisches Jahrbuch II, 1916, f. 1-30) na jep një kumtim përmbledhës, e pastaj një trajtim të hollësishtëm në revistën Kuhns Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung¹). Këtu, pas një hyrjeje historike të shkurtër, gjejmë trajtim tingujt bashkë me një vështrim të përgjithshëm të veçorive fonetike, pastaj format e sistemit nominal e verbal si dhe, më shkurt, ndërtimi sintaktik. Punimin e mbyll një glosar i pasur. Një vëmendje të veçantë i kushton autori ndikimit që ka ushtruar — e që vijon të ushtrojë — mjedisi roman i rrethinave mbi gjuhën e këtyre kolonive, mbi sistemin fonetik e morfologjik të saj e mbi visarin e fjalëve që përdorin. Përveç kësaj aty merret në shqyrtim edhe çështja se nga ç'anë të Shqipërisë janë shkullur këta kolonistë, dhe për caktimin e kësaj prejardhje të tyre ndiqet e vetmja rrugë, që është metodikisht e drejta, duke u mbështetur d.m.th. në emrat e familjeve dhe në tiparet e veçanta të

dialektit të tyre. Në këtë punim përveç gjuhëtarit gjejmë lëndë dhe folkloristi e historiani i literaturës. Sepse ky dijetar, duke i mbetur besnik prirjes së brendëshme të tij, mblo dhi e botoi aty edhe këngë e të tjera tekste popullore, dhe i shqyrtoi këto edhe në lidhjet që kanë me tekstet italiane jugore që u përgjigjen, të cilat shpeshherë kanë qenë dhe gjedhja e tyre.

Një tjetër trevë e gjurmimeve dialektore të Lambertzit është Shqipëria veriake. Fryti i parë i shtektimeve kërkimore të tij në ato anë qe punimi «Kumtim për studimet e mia linguistike në Shqipëri nga mesi i majit gjer në fund të gushtit 1916» botuar në Kumtari (Anzeiger) i Akademisë së Shkencave të Vjenës. Aty, mund të themi, për të parën herë na jepet një ndarje shkencore e zonës së gegërishtes në krahina dialektore bashkë me kalimet graduale prej krahine në krahinë. Të folët e Gjakovës me të Kosovës përfshihen në një grup, nga i cili largohen ligjërimet e Malsisë që çojnë te të folët e qytetit të Shkodrës. Një grup më vete përbëjnë, me trajtat e tyre fonetike, dialektet e Mirditës, Lurës, Kthellës e Matit. Një tjetër grup formojnë ligjërimet e Krujës, Tiranës e të Malësisë së Tiranës. Është për të vënë re që kjo ndarje dialektore përkon në vija të përgjithëshme me ndarjen etnografike të trevës geqe në tri zona që shkojnë prej perëndimi në lindje, zona veriore, e mesmja dhe jugorja (Malsia, Leknia, Gegnia), si e ka konstatuar Rrok Zojzi në këto kohët e fundit. Vijat divergjente e vijat konvergjente që karakterizojnë dialektet shqiptare ravizohen në studimin përmbledhës «Dialektet e shqipes» (1944, Albanisches Lesebuch I, 1949, f. 12-21). Në një vepër të mëvonë²) bëhet një diferencim edhe më tej i gegërishtes, duke e ndarë këtë në gegërishte veriore, verilindore, të mesme e jugore. Toskërishtes Lambertzi — duke lënë mënjatë këtu vrejtit e veçanta përdredhur vise-vise në studimet e tij italo-shqiptare — i ka kushtuar vëmendjen e tij në punimin me titull «Shqipja e jetës së përditshme», ku në bazë të literaturës me karakter popullor shikohet të folët e Gjiro-

1) 51 (1923) 259-290; 52 (1923) 43-90; 53 (1925) 66-79, 282-307.

2) Lehrgang des Albanischen Teil III. Gramatik der albanischen Sprache (1959) 1-64.

kastrës në aspektet e ndryshme të tiat. Bigëzimin dialektor të shqipes ai në këtë mes me të drejtë e vështron mbi një bazë historike, dhe arsyet e diferencimit ndër të tjera i gjen te orientimi i ndryshëm kishtar, te fatet historike që kanë ndarë krahinat nga njëra-tjetra, te ndryshimet e nivelit kulturor e të shtresave sociale. Gjendjen e kërkimeve dialektologjike tani rishmë na e paraqet artikulli «Dialektet e shqipes. Gjendja e sotme e kërkimeve, botuar në të përkohëshmen Südost-Forschungen XVI (1957) 430 vv.

Nga lëmi i sintaksës do të përmendet këtu studimi pothuajse shterues «Perioda hipotetike në gjuhën shqipe», botuar më 1914-15 në Indogerm. Forschungen 34, f. 44-208. Aty autori, duke u mbështetur më një material të pasur, marrë prej teksteve të vjetra e së reja të literaturës artistike popullore, merr në shqyrtim më parë lidhëzat me të cilat nis fjalja kushtore dhe pënyrën e përdorimit të tyre. Pastaj hetohet zhvendësimi i fjalisë kushtore me ndërtime të tjera, përdorimi i fjalive kushtore me të tjera funksione dhe thurja e disa fjalive kushtore; e më tej trajtohet fjalja kushtore koresponduese me kuptim disjunktiv, mohimi në fjalitë parciale dhe vendi i fjalëve (topika) në periodën hipotetike; më në fund jepet një vështrim i përgjithshëm mbi tipet e rasës irrealë. Momenti psikologjik dhe nuanca stilistike vihen në dukje me kompetencë të madhe. Korniza shkencore e punimit zgjerohet me krahasimet që bëhen nga një anë me gjuhët romane perëndimore, nga një anë veçanërisht me rumanishten. Metoda e provuar e shfrytëzimit të një materiali burimor të begatshëm dhe e krahasimeve me gjuhë të tjera na cfaqet dhe në artikullin e shkurtër «Dy albanica» (Zeitschrift für indogerm. Forschungen 60, 392 vv.). Aty flitet ndër të tjera për aoristin më -va, po merret në vështrim dhe aoristi sigmatik si dhe tkurja e tërheqja e madhe e këtij nga puna e përhapjes së tipeve të tjera të aoristit.

Ky dijetar në rrymë të vjetve ka hartuar dhe shumë vepra që përuhin në mësimin praktik të gjuhës shqipe. Më 1913 botoi bashkë me gjuhëtarin shqiptar Gjergj Pekmezini doracakun «Libër mësimi e leximi i shqipes». Nga këto libra, vepra dy blësh «Libër leximi i shqipes», me

nivelin shkencor që e shquan i kalon caqet e një libri praktik të mësimi. Bleu i parë, përveç hyrjes dhe të dhënave bibliografike, përmban një kapitull mbi dialektet e shqipes e ndryshimet që ekzistojnë midis tyre, një skicë gramatike me ushtrime, dhe shumë tekste, edhe nga fundi biografitë e autorëve dhe studimin «Gjeneza e zhvillimi i literaturës shqiptare» Bleu i dytë jep tekste e të parit, përkthyer gjermanisht. Një tjetër veprë me të tilla përmasa të mëdha, e cila bashkon në vetvete cilësitë e vëzhgimit teorik me ato të udhëzimit praktik, është edhe vepra tri pjesësh «Kursi i shqipes». Pjesën e parë të kësaj veprë e përbën Fjalori shqip-gjermanisht që u botua më 1954, paracaktuar më fort për të ndihmuar në kuptimin e copave letrare të leximit. Këto vetë përmbahen në pjesën e dytë, që është «Kreshtomacia shqiptare» që u përmend më lart, botim i vitit 1955. Pjesa e tretë, vepra me titullin «Gramatika e gjuhës shqipe» që edhe kjo u zu ngoje më sipër, paraqitet veçanërisht e pasur e e plotë. Dialektologjia, gramatika, copa të zgjedhura të literaturës artistike e popullore e shumë gjëra të tjera gjejnë aty një trajtim organik e të ndërlidhur, duke u thurur, pas metodës së provuar, paraqitja shkencore me udhëzimin praktik të mësimi të gjuhës.

Ky dijetar gjatë së parës luftë botërore, kur Shqipëria veriake ishte e pushtuar nga trupat austro-ungareze, mori pjesë në Shkodër në punimet e «Komisës Letrare», e cila, sikundër dihet, mund të thuhet se vuri gurin themeltar në normimin e shkrimit e në ortografinë e sotme të shqipes. Ndërkaq do thënë se Lambertzi, si atëhere si më pastaj, ka mbajtur qëndrim ndaj çështjes së gjuhës së përbashkët e të shkrimit, e cila në atë kohë — e nga disa pikëpamje edhe sot — ishte në të lindur e sipër; veçse ai nuk u përzie praktikisht në këtë çështje, sikurse pat bërë dikur Krumbacheri në çështjen e gjuhës në Greqi. Ai është shprehur çiltas kundra një gjuhe të përzier gege-toske, kundra një gjuhe që nuk flitet gjëkund, kundra hapjes së një greminë të thellë midis njerëzve të zyrës, të shkollës e të kulturës dhe njerëzve të popullit, kundra lindjes së një diglosie artificiale, si-

kundër ekziston dhe sot e gjithë ditën në Greqi.

Nga fushat e gjuhësisë që kanë zgjuar qëmoti interesimin e veçantë të këtij dietari, do përmendur këtu mënyfund — last not least — dhe onomastika. Në vitin 1911 — siç po shoh tani nga nekrologu i C. Haeblerit në Gnomon 1963, f. 846) — ai botoi artikullin «Sistemi i emrave dyfishë» (Program, Vjenë) e në vjetët 1913 e 1914 artikullin «Përhapja e super-nomen-it në Perandorinë romake» (Glotta IV 78-143, V 99-170). Nga fusha e shqipes atë e tërhoqi kryesisht studimi i emrave personale, ku Johan Georg von Hahn (1854) ka qenë ai që pat kryer punë pioneri. Lambertzi që në krye të herës e gjer në fund të jetës së tij u muar me emrat shqip të burrave e të grave, me trajtat e tyre të shkurtuarat e me formantet që përbëjnë këto trajta, si -k -kë: **Prend Prenk, Ndue Ndok, Ndre Ndrekë**. Ai që heret — ashtu si më parë Paul Kretschmeri — dhe ç'është e drejta, më parë se të niste era e studimevet onomastike, vuri re rëndësinë që kanë emrat vetiake për hetimin e burimit të popullit shqiptar e të gjuhës së tij. Ashtu si dhe në disa punime të mëparme, ai sidomos dhe në artikullin «Dy albana» që u citua më lart, vuri në pah faktin që disa emra ilire vazhdojnë të rrojnë në emrat vetiake shqiptare, si **Dasas Dasimius Dazos: Dash, Dida: Dedë, Bardus Bardylis: Bardhi** etj. Këtë W. Cimochowski (Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencaat Shoqërore XII 2, 1958, 47) e gjykon me të drejtë si një nga argumentat që vërtetojnë filiacionin, birërinë ilire të shqipes. Tek emrat vetiake Lambertzi është kthyer shpeshherë. Kështu, me rastin e recensimit që i bëri në revistën Südost-Forschungen (XIV, 1955, 508 vv.) artikullit «Emrat e ditve të javës dhe të muajve në gjuhën shqipe» të Wilhelem Gieses, ai flet dhe për emrin e **Prende-s** e cila i përgjigjet përndëshës Venus të Romakëve e prej së cilës ka marrë emrin dita e **premtë** «dies Veneris», dhe lidhur me atë flet edhe për emrin e ditës e **enjte**.

Që në fillimet e karrierës shkencore të tij Lambertzi përveç se për gjuhësinë e për literaturën shqiptare, ka dëftuar një interesim të madh edhe

për folklorin shqiptar, për poezinë popullore në kuptimin më të gjerë të fjalës. Ai si për literaturën artistike, ashtu edhe për poezinë popullore shqiptare ka vënë në dukje karakteret origjinale që e dallojnë nga poezia e popujvet fqinj, me gjithë se dihet që ka dhe shumë tipare të përbashkëta me disa popujve të Ballkanit në këtë rushë.

Te «Luna e Shqipniës»¹⁾ që doli gjatë së parës luftë botërore në Shkodër ai botoi gjermanisht studimin e gjatë «Poezia popullore shqiptare», i cili doli dhe në formë libri në Sarajevë, në serinë e botimeve «Për njohjen e Gadishullit ballkanik» që drejtonte Karl Patschi. Këtu trajtohet pikësepari kënga popullore nga ana e formës, e përmbajtjes dhe e stilit të saj; në mënyrë të veçantë shqyrtohet imët melodija e ritmi, rima e ndërtimi i vargut. Nga gjinitë poetike, përveç përrallës e legjendës gjurmohet sidomos poezia epike e poezia lirike: kënga heroike bashkë me teknikën epike, me krahasimet e dendura e me vargjet si hyrje që kanë lidhur me natyrën, pastaj kënga e dashurisë dhe kënga e dasmës, vajtimi, këngët e fëmijëve, vargjet e numërimt, këngëzat e motit e të shiut etj.

Një nga kryeveprat e këtij dietari mbetet libri «Përralla shqiptare e të tjera tekste të folklorit shqiptar» botuar nga ana e Akademisë së Shkencave në Vjenë më 1922 dhe kush-tuar mësuesit të tij Paul Kretschmerit. Përveç përrallave, legjendave e anekdotave mbledhur nga goja e popullit e botuar shqip dhe me përkthim gjermanisht, kjo vepër përmban si hyrje një studim të gjatë, ku trajtohen figurat e përrallës e të besimit popullor, siç janë kulshedrat e dragojtë, lugetët e shtrigat, hiet e vitoret, orët e zanat, divat e thopçit, e Bukura e dheut e harapi, qerosi dhe Tosku e Mosku. Vijnë pastaj temat që dalin nëpër përralla e nëpër këngë popullore, si legjenda e murimit (kalaja e Shkodrës) dhe e Lenorës (Kostandini e Garentina), tema e dhëndërit që kthehet në shtëpi (Aga Ymeri) dhe ajo e ndëshkimit të gruas së pabesë. Në një tjetër kapitull merret në shqyrtim forma e përrallës shqiptare; veçanërisht jepen formulat stereotipe me të cilat nisim përrallat e ato — më të shumëllojshme — me të cilat mbarojnë. Kësaj hyrje,

1. Viti 1917, kallnuer-mars, Nr. 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25.

e cila ka randësi për mbarë folklorin e popujve ballkanikë, i prin një literaturë e hollësishtme, dhe e plotë gjer në atë kohë, e përrallës shqiptare, e cila do t'ish mirë të vazhdohej gjer në ditën e sotme. Studimin e përrallave shqiptare e ballkanike dhe përhapjen e tyre ai e çoi më tej në botimet gjermanisht «Midis Drinit e Vjosës. Përralla prej Shqipërie» (1922), «Nga Briri i Artë. Përralla greke të mesjetës», përkthyer gjermanisht pas tekstit origjinal (1922), «Motra me krahë dhe të Errëta e dheut» (1952) dhe «Shqipëria rrëfen» (1925). Ndërkaq do përmedur këtu së rrugën në studimin e përrallave e të legjendave shqiptare e pat çelur Hahn i që në shekullin e kaluar, sidomos me veprat «Përralla greke e shqiptare (1864) e «Studime rreth legjendave» (Sagwissenschaftliche Studien, 1872-76), duke u përpjekur të caktonte tiparet qenësore të përrallës shqiptare e të stilit të saj. Prej Hahnit çojnë fijet më një anë te A. Leskien e M. Lambertzi, më anë tjetër të P. Kretschmeri, N. Jokli, F. Nopcsa e te të tjerë dijetarë.

Një dashuri të veçantë ka ushqyer Lambertzi gjatë gjithë jetës së tij për Këngët e Kreshnikëve, për rapsoditë e Veriut që këndojnë me lahutë trimëritë e dy vëllezërve Muji e Halili e të shokëve të tyre në luftat që bëjnë kundra «Krajlit» e trimave të tij. Këtë temë ai e pat rrokur që me studimin e tij mbi poezinë popullore shqiptare të vitit 1917 e me veprën «Përralla shqiptare» Po më 1954-55 ai këtij subjekti, i cili ka një rëndësi që i kapërcen caqet e botës shqiptare, i kushtoi një studim të gjerë, me titullin «Epika popullore e shqiptarëve», ribotuar dhe më 1958 në formë libri. Në këtë studim të habit mbi të gjitha paraqitja e gjallë e realiste e jetës shqiptare me ato elemente që e krakterizojnë, dhe analiza e thelluar e mjedisit (ambientit) ku lëvizin figurat kryesore. Duke u nisur nga parimi i interpretimit të poezisë nga jeta, Lambertzi shqyrton heronjtë vetë me emrat e tyre (zakonisht tripjesëshe) e me tiparet e tyre fizike e shpirtërore, atllarët e armët e tyre, aventurat, gostat e belegjet. Një rol me rëndësi në botën e këtyre kavalierëve mesjetarë

të Ballkanik e luajnë gratë, me cilësinë e tyre si nëna, të shoqe e dashnore. Prandaj aty merren në shqyrtim fejesat e rrëmbimet e vashave, besa e pabesia e grave, ritet e martesës e vajet. Që aty gjejnë trajtim edhe elementet e lashta të jetës së popullit shqiptar, siç janë ndër të tjera kushtrimi, pritja e mikut, vëllamia (probatinia), pretimet, kumbaria, këngët me lahutë, kullat, pleqësitë, gjaqet, të përzierit e qenieve të mbinatyrshe të besimeve popullore në ndodhitë e jetës si te Homeri, kjo te Lambertzi kuptohet vetvetiut. Një vemendje e veçantë u kushtohet qendrave gjeografike të ngjarjeve që përmenden në këtë cikël epesh, si ato që janë të përcaktueshme, si Kotorri, Jutbina etj., si ato më të përgjithshmet, si «Bjeshkët» e «Lugjet e verdhra». Atyre më anë tjetër u përgjigjen figurat epike, te të cilat autori me kompetencë të rrallë dallon elementin legjendar e fantastik («të shtatë krajlrat» etj.) nga ai që mbështetet më realitetin historik. Si një meritë e veçantë e autorit do shikuar fakti që ai vë në dukje edhe ndjenjat njerëzore më të holla që dalin në këto këngë siç është dashuria e djalit për nënën dhe ajo e vëllait për motrën. Me këto vëzhgime etnografike-kulturhistorike vjen e ndërthuret shqyrtimi i mirëfilltë i epikës popullore. Aty ndër të tjera konstatohen elementet realiste e moderne të këngëve, motivi i hiles, hiperbolat, mënyra e fillimit të këngëve, fillimi me një motiv marrë prej natyrës si formulë stereotipe e si mjet artistik. Dne në lidhje me formën e epeve trajtohen metrika, mbushja e vargut me pjesëzat, admirativi, ndërtimet emfatik, proliksiteti, repetio epica, epitetet, krahasimet, formulat stereotipe e të tjera. Me përkthimin gjermanisht e botimin e njëzet rapsodive nga ky cikël ai e bëri të njohur këtë botë epike edhe në një qark ndër-kombëtar më të hapët. Mitologjisë shqiptare ky dijetar i ka kushtuar interesimin shkencor gjer në ditët e sprasme të jetës së tij. Për këtë dëshmon dhe një punim që e kreu në shtratin e lëngimit të fundit, i cili do të botohet në veprën e madhe kolektive «Mitologjia e popujve».

Te Maximilian Lambertzi kemi bjeerrë një njeri bujar e një dijetar të

shënuar. Ai është një nga të sprasmit nga ai varg shkencëtarësh të Austrisë së vjetër, të cilët — si Hahni, Miklosichi, Gustav Meyeri, Jireçeku, Sufflay, Patschi, Jokli, Nopcsa, Haberlandti — kanë çuar përpara studimet shqiptare në një mënyrë të shënueshme. Ai është një nga ata më të pakët ndër këta, të cilët në gjurmimin e problemeve shkencore janë nisur nga një vështrim tërësor i rre-

thanave objektive, duke kombinuar sidomos të dhënat e etnografisë me ato të gjuhës e të literaturës. Ndër të tjera edhe me anë të kësaj metode kërkimore e me rezultatet ku arriti nëpërmjet të saj ai ka kryer një punë që do të mbetet, ai u ka çelur rrugën brezave të dijes së mëpashtajme.

EQREM ÇABEJ